



GRANTE TË BASHKËFINANCUARA
PËR SHOQËRI TREGTARE TË SAPOTHEMELUARA
START-UP DHE SPIN-OFF

START UP #6

QËLLIMI

Të inkurajohet zhvillimi i inovacionit tek ndërmarrjet e sapothemeluara përmes sigurimit të mbështetjes së nevojshme financiare për aktivitetet që lidhen me hulumtimin dhe zhvillimin.

Të inkurajohet zhvillimi i kulturës së marrjes së rrezikut dhe inovacionit, të sigurohet mbështetje për personat juridikë që dëshirojnë të zhvillojnë produkt, proces dhe/ose shërbim të ri apo të përmirësuar, si dhe të inkurajohet komercializimi i rezultateve nga hulumtimet e kryera në kuadër të institucioneve të arsimit të lartë respektivisht të institucioneve hulumtuese-shkencore.




A photograph of a business meeting. Several people are seated around a wooden table. One person in the foreground is holding a black pen and pointing at a tablet displaying a colorful bar chart. Another tablet is visible on the left side of the table. There are two coffee cups, one with a black lid and one with a white lid. A stack of papers and a pen are also on the table. The background is slightly blurred, showing other participants in business attire.

Çfarë projektesh mbështesim

Mbështetja përmes këtij instrumenti do t'u jepet projekteve që kanë të paktën "dëshmi të konceptit" (proof of concept) dhe ambicie të qartë për komercializim. Instrumenti mbështet projektet të cilët janë në fazën e dëshmimit të konceptit deri në fazën e parakomercializimit (para tregtimit).


Kush mund të aplikojë:

- - Shoqëri tregtare e themeluar në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare dhe e regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose ekip i përbërë nga maksimumi 5 anëtarë - persona fizik.
- - Të ardhurat vjetore të aplikuesit nuk duhet të kalojnë 1,000,000 euro në kundërvlerë të denarit, sipas raporteve financiare për dy vitet e mëparshme fiskale;
- - Numri mesatar i të punësuarve nuk duhet të kalojë 250 të punësuar;
- nga momenti i regjistrimit të shoqëris tregtare deri në momentin e paraqitjes së propozim-projektit në Fond të mos kenë kaluar më shumë se 6 vite;
- - Shoqëria tregtare të jetë në pronësi të personit fizik dhe/ose juridik (që nuk është në pronësi shtetërore),/shoqatë ose fondacion dhe/ose institucion që kryen arsimin e lartë, respektivisht veprimtari hulumtuese-shkencore (me aksione pronësie në aplikuesin deri në 20%);
- - Aplikuesi ose ortakët e tij/aksionarët nuk janë drejtpërdrejt ose indirekt pronarë me mbi 20% në një tjetër shoqëri tregtare/të ardhurat vjetore individuale të të cilave tejkalojnë 1,000,000 euro në kundër vlerë në denarë në dy vitet e mëparshme fiskale dhe mesatarja e numrit individual të të punësuarve nuk i kalon 250 punonjës, me përjashtim të rasteve të lidhjes me institucion të arsimit të lartë, respektivisht me institucion hulumtues-shkencor;



Kush mund të aplikojë:

- - Kundër tij nuk është ngitur procedurë falimentimi ose likuidimi;
- - Të ketë shlyer detyrimet e maturuara në bazë të detyrimeve dhe kontributeve publike;
- - Kundër tij të mos ketë filluar procedurë për ekzekutim me forcë të kërkesave monetare të maturuara;
- - Në pajtim me Ligjin e Kontrollit të Ndhmës Shtetërore dhe Dekretin për kushtet dhe procedurën e dhënies së ndihmës me rëndësi të vogël (de minimis) të plotësojë kushtet e mëposhtme:
 - - Të mos ketë akumuluar më shumë se 200,000 euro ndihmë me rëndësi të vogël për një periudhë trevjeçare fiskale, përfshirë dhe shumën e kërkuar të mjeteve nga Fondi;
 - - Të mos ketë akumuluar më shumë se 100,000 euro ndihmë me rëndësi të vogël për një periudhë trevjeçare fiskale, përfshirë shumën e kërkuar të mjeteve nga Fondi, nëse ndërmarrja është aktive në sektorin e transportit rrugor;
 - - Të mos jetë në vështirësi (ndërmarrje në vështirësi është një ndërmarrje që nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e saj nga burimet e veta ose me mjete që mund të marrë nga pronari i saj / aksionarët ose kreditorët, për të ndaluar humbjet, të cilat pa ndërhyrje të jashtme nga ofruesit e ndihmave me siguri që do të çojë në ndërprerjen afatshkurtër dhe afatgjatë të punës së ndërmarrjes), dhe
 - - Të mos merret me prodhimin e qymyrit.



ÇFARË AKTIVITETE MBËSHTESIM



- - Aktivitete për hulumtim dhe zhvillim;
- - Zhvillim të linjave pilot/prodhim dhe/ose shërbim/;
- - Aktivitete për testimin dhe validimin e produkteve/shërbimeve/proceseve të reja dhe/ose të përparuara;
- - Aktivitete për testimin e tregut dhe validimin e shfrytëzuesve potencialë;
- - Aktivitete të lidhura me mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe
- - Dizajnim.



SHPENZIME TË PRANUESHME PËR FINANCIM

- Pagat bruto me shtesat e pagës të përfshira, të përcaktuara në përputhje me Ligjin e Marrëdhënieve të Punës për personat që janë ose do të punësohen tek shfrytëzuesi dhe marrin pjesë drejtpërdrejt në zbatimin e projektit;
- Furnizimi dhe/ose huazimi i pajisjeve dhe materialeve harxhuese për hulumtim dhe zhvillim;
- Shërbimet e nënkontraktuara për hulumtim dhe zhvillim;
- Angazhimi i ekspertëve/këshilltarëve për hulumtim dhe zhvillim;
- Angazhimi i konsulentëve për nevoja të lidhura drejtpërdrejt me rezultatet e projektit;
- Përgatitja dhe parashtrimi i kërkesës për patent, mbrojtje të markës tregtare dhe/ose dizajnit industrial;
- Mbështetje për zyrën dhe biznesin në një shumë maksimale prej 15% të buxhetit të përgjithshëm të projektit.



2.000.000 EUR

buxheti total i thirrjes



Deri në 90% të buxhetit të përgjithshëm të projektit, por jomë shumë se 40,000 euro për shoqëritë tregtare deri në 3vjet ekzistencë deri në momentin e aplikimit ose për projektetë paraqitura nga një ekip projekti.

Deri në 85% të buxhetit të përgjithshëm të projektit, por jomë shumë se 60,000 euro për shoqëritë tregtare me më shumë se 3 dhe më pak se 6 vjet ekzistencë deri në momentin e aplikimit.

Aplikuesi siguron 10% ose 15% të buxhetit të përgjithshëm të projektit.

* Kohëzgjatja e projektit mund të jetë deri në 12 muaj.

Evaluumi I projekteve

-1-

Faza e para-përzgjedhjes kryhet nga tre ekspertë vendas.
Dy ekspertë nga fushat që korrespondojnë me kriteret e
evaluimit dhe një person nga fusha që korrespondon me
propozim projektin.

-2-

Faza e përzgjedhjes kryhet nga Komisioni i Miratimit të
Investimeve, i cili merr vendimin përfundimtar për
financimin nëpërmjet këtij Instrumenti





Si i vlerësojmë projektet

- Shkalla e inovacionit;
- Cilësia e projektit;
- Kapaciteti i ekipit të projektit;
- Potenciali i tregut;
- Ndikimi.

Dokumentacioni i projektit

- Formulari i aplikimit të projektit i plotësuar siç duhet;
- Formulari i buxhetit të projektit i plotësuar siç duhet;
- Deklarata e Aplikuesit për pranimin ekushteve të Fondit;
- Pyetësorë për mjedisin jetësorë dhe
- Deklaratë e noterizuar për pronësinë –struktura themeluese e aplikuesit;
- Biografi të shkurtëra të personave qëpërbëjnë ekipin e projektit të angazhuarnë projekt (më së shumti për 5 persona).

**Afati i aplikimit deri më:
15.04.2024 ora 14:00.**

startapuvaj6@fitr.mk

